



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:326051
Datë: 10.03.2025
Numri i dokumentit: 06964928

C.nr.4282/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Nexhmie Shala nga Fshati Loxhë Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson Besim Ahmetaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Prisig” në Prishtinë, rruga “Eduard Lir” numër 173, baza juridike: kompensim dëmi sipas auto – përgjegjësisë, vlera e kontestit: 1000 euro, jashtë seance gjyqësore me datë 10.03.2025, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET së është tërhequr padia e datës 15.11.2024, e parashtruar nga paditësja Nexhmie Shala nga Fshati Loxhë Komuna e Pejës, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Prisig” në Prishtinë, rruga “Eduard Lir” numër 173, baza juridike: kompensim dëmi sipas auto – përgjegjësisë, vlera e kontestit: 1000 euro.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë me datë 15.11.2024 ka parashtruar padi kundër të paditurës, nga baza e kontestit: kompensim dëmi sipas auto – përgjegjësisë, vlera e kontestit 1000 euro.

I autorizuari i paditëses me parashtruesin e datës 07.03.2025, të dorëzuar pranë kësaj gjykate, e ka bërë tërheqjen e padisë, ndaj të paditurës me arsyetimin se paditësja me të paditurën kanë arritur ujdë jashtë gjyqësore.

Gjykata në kuptim të nenit 261. Par.1,3 dhe 4 e lidhur me nenin 387, par 1, pika “c” të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:326051, C.nr.4282/24, 10.03.2025

Udhëzim juridik: *Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 e LPK-së.*

G J Y Q T A R I
Vegim Maloku